

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Eksperti ngre shqetësime për infiltrim dhe luftë hibride pas protestave të Hagës: Të hetohen incidentet e dhunshme
ADRESA	https://albeu.com/kosove/eksperti-ngre-shqetesime-per-infiltrim-dhe-lufte-hibride-pas-pr-otestave-te-hages-te-hetohen-incidentet-e-dhunshme/1024668/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:51:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 15:15:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2d10b59a06d812673a3062450f342fe5b33bbe4f331678713c4b8b5d71e636f2
TEKSTI	ebb4e36f27af7b63a340ad4c339f5e599f32663430d2e69003616bedc3d657af
PAMJA	8c0ec26aeb3c11768bdb5dc0f310aff9d6f0fb584680d0c2966f7276312fb5c4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c3b099381d90a68be9dd9b172e32af6667d1654e1dc7bbfb2432df22f652aba6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c3b099381d90a68be9dd9b172e32af6667d1654e1dc7bbfb2432df22f652aba6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ekspteri ngre shqetësime për infiltrim dhe luftë hibride pas protestave të Hagës: Të hetohen incidentet e dhunshme



Sonte do të mbahet protesta e tetë pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, ku u dënuan katër ish-drejtuës të UÇK-së.

Ato përveç reagimit qytetar, sollën edhe incidente të izoluara me persona të maskuar që hodhën mjete të ndryshme drejt institucioneve dhe forcave të sigurisë.

Ekspteri i sigurisë, Bedri Elezi, thotë se situata duhet të analizohet përtej dimensionit të një proteste të zakonshme, duke bërë dallim mes qytetarëve që protestojnë në mënyrë paqësore dhe individëve që përdorin dhunë apo tentojnë të shkaktojnë përshkallëzim.

Sipas tij, protesta qytetare është një e drejtë demokratike dhe zemërimi i qytetarëve për një çështje që prek drejtpërdrejt historinë dhe ndjenjat e shoqërisë kosovare është i kuptueshëm. Megjithatë, Elezi thekson se momenti kur persona të maskuar përdorin dhunë dhe sulmojnë institucione apo forcat e sigurisë, çështja nuk mund të trajtohet vetëm si protestë politike.

"Ajo që ndodhi pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë duhet të analizohet përtej dimensionit të një proteste të zakonshme. Protesta qytetare është një e drejtë demokratike dhe zemërimi i qytetarëve, veçanërisht për një çështje që prek drejtpërdrejt ndjenjat dhe historinë e shoqërisë kosovare, është i kuptueshëm. Por momenti kur persona të maskuar fillojnë të përdorin dhunë, të hedhin gurë apo mjete të tjera drejt institucioneve dhe forcave të sigurisë, situata kalon nga protesta politike në një çështje të sigurisë publike dhe potencialisht të sigurisë kombëtare", shprehet Elezi.

Ekspteri i sigurisë thotë se nuk duhet të barazohet protestuesi paqësor me personin që kryen veprime të dhunshme. Sipas tij, kritika duhet të përqendrohet te veprimet konkrete të individëve dhe te prirja që mund të

të fundit /



Ekspteri ngre shqetësime për infiltrim dhe luftë hibride pas...



Foda: "Synimi është fitorja", Kaçuri dhe Osmani pajisen me...



Egnatia me uniforma të reja në Conference League, rrogzhinasit...



Kuvendi e kalon në shqyrtim reformën territoriale, pa...



GJKKO njofton seancën e pyetjes për ish-drejtesen e...



Një 44-vjeçar në Itali akuzohet se u mori grave foto dhe video...



Gjykata Kushtetuese rrëzon nismën e "Të Majtës" për fushatën...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

unionshme. Sipas tij, natyrisht duhet të përqendrohet te veprimet konkrete të individëve dhe të provat që mund të dëshmojnë nëse incidentet kanë qenë spontane apo të nxitura dhe të koordinuara.

"Këtu duhet të bëjmë një dallim shumë të qartë: protestuesi paqësor nuk është kërcënim për shtetin; personi që përdor dhunë, maskohet për të fshehur identitetin dhe përpiket të shkaktojë përshkallëzim, duhet të trajtohet mbi bazën e veprimeve të tij konkrete dhe provave. Pikërisht kjo ndarje është e rëndësishme, sepse nuk mund të vendoset e gjithë një protestë qytetare nën të njëjtin emërtim për shkak të veprimeve të një grupi të vogël individësh", thotë ai.

Elezi vlerëson se një nga rreziqet kryesore në situata të tilla është instrumentalizimi i zemërimit real qytetar nga individë apo struktura që mund të kenë agjenda të tjera.

Ai përmend mundësinë e luftës hibride, ku, sipas tij, një aktor i jashtëm nuk ka nevojë domosdoshmërisht ta organizojë një protestë nga fillimi, por mund të tentojë të ndikojë në një situatë ekzistuese tensioni.

"Rreziku kryesor në një situatë të tillë është që zemërimi real qytetar të instrumentalizohet nga individë ose struktura me agjenda të tjera. Kjo është pikërisht një nga karakteristikat e luftës hibride. Nuk është e domosdoshme që një aktor i jashtëm të organizojë një protestë nga fillimi. Mjafton që të përpiket të ndikojë në një moment ekzistues tensioni, të identifikojë pikat e dobëta, të nxisë përshkallëzimin, të manipulojë informacionin dhe ta kthejë një protestë legjitime në përplasje me institucionet", deklaroi eksperti i sigurisë.

Duke folur për mundësinë e përfshirjes së shërbimeve të huaja, Elezi përmend edhe BIA-n serbe, por thekson se çdo pretendim për infiltrimin e protestave duhet të mbështetet në prova konkrete.

Sipas tij, institucionet e Kosovës duhet ta marrin në konsideratë edhe skenarin e ndërhyrjes së një shërbimi të huaj, pa e shpallur atë si fakt para se të përfundojnë hetimet.

"A mund të jetë BIA e Serbisë e interesuar për një skenar të tillë? Kjo duhet të trajtohet me shumë seriozitet, por edhe me standard profesional të provave. Nuk duhet të deklarojmë se personat e maskuar ishin të infiltruar të BIA-s pa pasur prova konkrete. Por, nga perspektiva e kundërzbulimit, mundësia e përpjekjes së një shërbimi të huaj për të shfrytëzuar një situatë të tillë është skenar që institucionet duhet ta marrin në konsideratë dhe ta hetojnë", thotë Elezi.

Ai kujton se në Kosovë janë trajtuar edhe më herët raste të dyshuara të spiunazhit që, sipas tij, lidhen me BIA-n, duke vlerësuar se kjo e bën të nevojshme që çdo dyshim për ndërhyrje të jashtme të shqyrtohet nga institucionet kompetente.

"Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në kontekstin e rasteve të spiunazhit që janë hetuar në Kosovë. Prokuroria Speciale ka bërë publike se ka trajtuar disa raste të dyshuara të spiunazhit të lidhura me BIA-n, përfshirë raste që kanë përfunduar me dënime. Prandaj, pyetja e sigurisë nuk duhet të jetë vetëm 'Kush po proteston?'. Pyetja duhet të jetë edhe kush po përpiket ta ndryshojë karakterin e protestës, kush po e nxit dhunën, kush përfiton nga destabilizimi dhe a ekzistojnë lidhje organizative, financiare, informative apo operative ndërmjet personave të përfshirë", shprehet ai.

Elezi thekson se institucionet e sigurisë duhet të shmangin përgjithësimet dhe të fokusohen te sjellja e individëve të përfshirë në incidentet e dhunshme.

Sipas tij, personat që protestojnë në mënyrë paqësore duhet të kenë të garantuar të drejtën e protestës, ndërsa ata që sulmojnë institucione apo dëmtojnë pronën duhet të hetohen dhe të përgjigjen para ligjit.

"Në këtë drejtim, institucionet e sigurisë duhet të analizojnë veçanërisht sjelljen, jo përkatësinë politike të protestuesve. Personat paqësorë duhet të mbrohen dhe të kenë mundësi të ushtrojnë të drejtën e protestës. Ndërsa individët që përdorin dhunë, sulmojnë institucionet, dëmtojnë pronën apo përpiqen të provokojnë përplasje duhet të identifikohen dhe të trajtohen mbi bazën e ligjit dhe provave", thotë Elezi.

Ai kërkon koordinim ndërmjet Policisë së Kosovës, institucioneve të inteligjencës dhe kundërzbulimit, prokurorisë dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Sipas tij, përveç materialeve filmike, duhet të analizohen edhe komunikimet publike e dixhitale, lëvizjet e personave të dyshimtë, koordinimi i grupeve dhe mënyra se si janë siguruar mjetet e përdorura gjatë incidenteve.

"Duhet të përdoren në mënyrë të koordinuar kapacitetet e Policisë së Kosovës, strukturave të inteligjencës dhe kundërzbulimit, prokurorisë dhe partnerëve ndërkombëtarë. Në veçanti duhet të analizohet materiali filmik, komunikimet publike dhe dixhitale, lëvizjet e personave të dyshimtë, koordinimi i grupeve, mënyra e sigurimit të mjeteve të dhunës dhe çdo lidhje e mundshme ndërmjet individëve. Vetëm përmes një analize të tillë mund të kuptohet nëse kemi të bëjmë me veprime individuale, me një grup të koordinuar apo me ndonjë përpjekje më të gjerë për të ndikuar në situatën e sigurisë", deklaroi ai.

Në fund, eksperti i sigurisë vlerëson se Kosova duhet të jetë veçanërisht e kujdesshme ndaj përpjekjeve për manipulim të tensioneve shoqërore, dezinformimit dhe ndikimit të jashtëm.

Ai thotë se institucionet nuk duhet të presin që një situatë e tillë të përshkallëzohet për të ndërmarrë masa, por duhet të identifikojnë paraprakisht indikatorët e mundshëm të rrezikut.

"Nuk duhet lejuar që një aktor i jashtëm apo një grup i vogël individësh ta marrë peng një protestë qytetare dhe ta shndërrojë atë në instrument destabilizimi. Nëse një person hyn në një turmë me qëllim të provokimit të dhunës, ai nuk duhet të identifikohet automatikisht me gjithë protestuesit. Pikërisht kjo ndarje është thelbësore për sigurinë kombëtare: të mbrohet e drejta e protestës dhe njëkohësisht të neutralizohet dhuna e organizuar", thekson Elezi.

Ai shton se nëse ekzistojnë prova për ndërhyrje të jashtme, ato duhet të dokumentohen dhe t'u dorëzohen institucioneve kompetente, ndërsa në mungesë të tyre nuk duhet të krijojnë akuzë të rrethuara.

institucionëve kompetente, ndërsa në mënyrë të tyre nuk duhet të krijohen akuza të pabazuara.

"Nëse ekzistojnë prova për ndërhyrje të jashtme, ato duhet të dokumentohen, të hetohen dhe t'u paraqiten institucioneve kompetente. Nëse nuk ekzistojnë prova, nuk duhet të krijohen akuza politike apo publike të pabazuara. Por një gjë është e qartë: në një shtet të ekspozuar ndaj luftës hibride dhe që tashmë ka përjetuar raste të hetimeve e dënimeve për spiunazh, çdo përpjekje për ta kthyer zemërimin qytetar në dhunë duhet të trajtohet si indikator serioz sigurie dhe jo thjesht si incident proteste", përfundon Bedri Elezi, ekspert i sigurisë.

Shtuar më 23.09.2026 17:15

Tags: dhuna , Eksperti , nxitje




Gruda: Vendimi i Kushtetueses konfirmon qëndrimet tona, 13 ditë p...



Dejona Mihali vlerëson vendimin e Kushtetueses: 14 ditë kohë për...



Ardian Gjini fajëson Kurtin pas vendimit të Kushtetueses: Kosova dr...



Cakolli paralajmëron për dilemën kushtetuese: Kush e përcakton 8 apo 15...



Nëntë zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës marrin pjesë në konferencën...




Ferit Hoxha: Kërkesa e Kosovës për t'u anëtarësuar në Kartën e...



Ish-diplomatët bëjnë thirrje që Kosova të ngrejë çështjen e Gjykatës...



Qorrolli zbulon afatin përfundimtar për zgjedhjen e Presidentit pas vendimi...



Kërko... Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.